

KONTRATË DHURIMI KUOTE

Sot në datën 23.08.2022, unë Aleksandros Bombaj, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, "LIVING ROOM ENTERTAINMENT" SH.P.K me NUIS M21808024L, dhe Z.Daniel Shima, nënshkruajmë në selinë e shoqërisë në adresën në Rrugën "Stavri Themeli", Njësia Bashkiake Nr.7, Pallati Shushica, Shkalla D, Ap.1,Tiranë, me vullnetin tonë të lirë dhe të plotë këtë kontratë dhurimi kuote si mëposhtë vijon :

DHURUES: Aleksandros Bombaj, emri i babait Blendi, lindur në Greqi në 27.12.2000, me Nr.Personal ID K01227051M dhe banues në Tiranë në adresën "Stavri Themeli", Njësia Bashkiake Nr.7, Pallati Shushica, Shkalla D, Ap.1,Tiranë.

PRANUESI I DHURIMIT: Daniel Shima, emri i babait Ibrahim, lindur në Tiranë në 19.08.1975, me Nr.Personal H50819040V, dhe banues në Tiranë në adresën Blv. Petro Nini Luarasi, Pallati "Vigan", Hyrja 1, Ap.25, Tiranë.

Objekti i Kontratës: Dhurimi i 50% të kuotës së kapitalit, të zotëruar nga dhuruesi që përbën 50% (pesedhjetepërqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "LIVING ROOM ENTERTAINMET" SH.P.K me NUIS: M21808024L me vlerë monetare 50 (pesedhjete) lekë tek perfituesi dhe pranimin e dhurimit nga Pranuesi i dhurimit si me poshte vijon:

1.Përmbajtja e kontratës:

- Në përputhje me Statusin e shoqërisë "LIVING ROOM ENTERTAINMET" SH.K.P me NUIS M21808024L, unë – Aleksandros Bombaj zotërues i 1 (nje) kuote e cila përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë "LIVIG ROOM ENTERTAINMET" SH.P.K, në cilësinë e palës dhuruese i dhuroj Z.Daniel Shima 50% te kuotes qe une zoteroj ne shoqerine e siperidentifikuar qe i korespondon 50% te kapitalit te shoqerise me vlere monetare 50(pesedhjete) lekë.
- Une Daniel Shima, ne cilesine e pranuesit te dhurimit falenderoj z.Aleksandros Bombaj dhe pranoj dhurimin ne perqindje 50% te kapitalit themeltar, me vlere monetare 50 (pesedhjete) lekë.
- **Kalimi i pronësisë dhe Pjeset takuese te ortakeve pas dhurimit.**

Me pranimin e ketij dhurimi, Ortakët e shoqërisë do jenë :

- Z.Aleksandros Bombaj, do te jete zotërues i (1) nje kuote, me Pjesëmarrja në përqindje 50 (%) te me vlere kapitali 50 lekë ne shoqerine tregtare "LIVING ROOM ENTERTAINMET" SH.P.K me NUIS: M21808024L.
- Z.Daniel Shima, do te jete zotërues i (1) nje kuote, me Pjesëmarrja në përqindje (%), 50 me vlere kapitali 50 lekë ne shoqerine tregtare "LIVING ROOM ENTERTAINMET" SH.K.P me NUIS M21808024L.

2. Detyrimet Tatimore te Dhurimit



Detyrimet tatimore, që lindin nga kjo kontratë do të llogariten dhe do të paguehn në përputhje me parashikimet ligjore të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

3.Deklarimet dhe Garancitë

Dhuruesi deklaron dhe garanton Pranuesit e Dhurimit si më poshtë :

a. Dhuruesi posedon kuotat të lira nga cdo barrë siguruese, peng, hipotekë, garanci pagese, barrë mbi interes, kufizim, opzion, pretendim, prokurë apo angazhime të tjera të cdo lloj natyre (secila me poshte "Barrë")

b. Nënshkrimi i kësaj kontrate nga Dhuruesit dhe plotësimi i kushteve të saj nuk përbëjnë shkelje apo janë në kundërshtim me normat e (i) statutit të Shoqërisë,(ii) ndonjë gjykim apo urdhër, vendimi gjyqësor, dekreti apo vendimi të cdo autoriteti vendas apo të huaj subjekt i të cilit janë Dhuruesit,(iii) ndonjë marrëveshjeje, license apo angazhimi në të cilin Dhuruesit apo Shoqëria janë palë, që do të cënonte aftësinë e tyre për të nënshkruar këtë kontratë apo për të përmbushur detyrimet që rrjedhin prej saj, (iv) me ligjin e Zbatueshëm,

c. Ka te gjitha aftesite juridike per te nenshkuar kete kontrate dhe nuk ka asnje pengese ligjore e cila do te cenonte dhurimin

Te Tjera

Kjo Kontratë përfaqëson marrëveshjen e plotë ndërmjet nesh në lidhje me transferimin e kuotave si më sipër dhe asnjë kusht i saj nuk do të amendohet, anulohët ose shfuqizohet, përvec sa parashikohet nga kjo Kontratë.

Kjo Kontratë nenshkruset nga ne palet ne 3(tre) kopje origjinale, ng ate cilat nje per tu regjistruar ne QKB dhe nje kopje per secilin prej nesh,

Duke qene dakort me sa me siper ne pasi e lexuam aktin deklarojme se jemi dakort me te, eshte ne perputhje me vullnetin tone te lire dhe te plote dhe e nenshkruejme rregullisht pa asnje verejtje duke vendosur nenshkrimin ne faqen e pare dhe emer mbiemer nenshkrimin ne faqen e dyte te kontrates.

Dhuruesi

Aleksandros Bombaj

Aleksandros Bombaj


Pranuesi i Dhurimit

Daniel Shima

Daniel Shima


